

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT

EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Konsultim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Jo e zbatueshme
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	30.07.2020
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	27.07.2020
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Jo
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Anisa Gjonedaj anisa.gjonedaj@infrastruktura.gov.al Arvenola Naumi Arvenola.Naumi@infrastruktura.gov.al

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Menaxhimi i veprimtarisë minerare në zbatim të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pas një periudhe rreth 6 (gjashtë) vjeçare, ka nxjerrë në pah nevojën e ndryshimeve ligjore me qëllim përmirësimin e mëtejshme të procedurave ligjore dhe lehtësimin e biznesit që ushtron veprimtari minerare.

Amendimet legislative, të përfshira në draftin e projektligjit përfshijnë një sërë shtesash, përmirësimesh dhe riformulimesh, të cilat synojnë azhornimin e tij me zhvillimet e reja në fushën e veprimtarisë minerare.

Ndryshimi i garancisë financiare të investimit për lejet e kërkim zbulimit

Në ligjin minerar aktual është parashikuar që shoqëritë e licesuara për veprimtarinë e kërkim zbulimit të depozitojnë çdo vit një Garanci financiare për realizimin e programit minimal të punës në vlerë të barabartë me investimit që është parashikuar të kryejë shoqëria për çdo vit. Depozitimi i një vlerë të tillë të garancisë financiare vlerësohet nga shoqëritë minerare si një barrë shumë e rëndë financiare pasi bllokun një pjesë shumë të konsiderueshme të likujditeteve të shoqërisë, të cilat mund të përdoren për të investuar në realizimit e programit minimal të punës së lejes minerare të kërkim-zbulimit. Me uljen e vlerës së garancisë në 10%, shoqëria ka mundësinë të investoj më shpejt në kohë dhe të përfundoj më shpejt punimet e kërkim zbulimit.

Ndryshimi i afatit të lejeve të kërkim zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore

Aktualisht në ligj është parashikuar se lejet e kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore kanë një afat vlefshmërie 1 vit nga hyrja në fuqi. Nga eksperiencia e shoqërive minerare të licesuara për veprimtarinë e kërkim zbulimit për materialet ndërtimore si dhe nga monitorimi i kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar në këto shoqëri është vënë re se në disa raste kjo kohë (1 vit) është e pamjaftueshme për të përfunduar punimet e kërkim zbulimit. Në draftin e projektligjit është parashikuar që Leja e kërkim-zbulimit të ketë afat vlefshmërie 1 vit nga hyrja në fuqi e saj,

me të drejtë shtyrje për një vit, me sipërfaqe jo më shumë se 50% të sipërfaqes fillestare. Për sipërfaqen e mbajtur për vitin e dytë subjekti do të paguaj 150 000 lekë/km², duke i dhënë kështu mundësinë subjekteve të përfundojnë punimet e kërkim zbulimit për pjesën e mbetur.

Transferimi i lejeve të dhëna me procedurë konkurruese

Një nga problemet e vërejtura në zhvillimin e aktivitetit minerar ka qënë pamundësia e transferimit të lejeve minerare të dhëna me procedura konkurruese. Duke marrë në konsideratë dinamikën e ndryshimeve që mund të ketë një shoqëri tregtare gjatë zhvillimit të veprimtarive të ndryshme që ajo mund të zhvillojë (jo vetëm në aktivitetin minerar) është propozuar që të lejohet mundësia e transferimit të lejeve të dhëna me procedurë konkurruese pas një periudhe 5 vjeçare nga data e dhënies së lejes dhe kjo leje të transferohet vetëm pas miratimit paraprak të ministrit.

Mundësia e paisjes me leje minerare të subjekteve pjesmarrëse në realizimin e projekteve për qëllime publike vendore ose kombëtare

Në ligjin minerar është parashikuar mundësia e paisjes me leje shfrytëzimi të karrierave për subjektet të cilat kanë fituar të drejtën e realizimit të projekteve me rëndësi kombëtare apo lokale. Momentalisht kjo e drejtë i jepet vetëm subjektit të krijuar nga njësi përkatëse e qeverisjes vendore ose subjektit, i cili ka fituar të drejtën e realizimit të projektit me rëndësi kombëtare.

Subjektet të cilat fitojnë të drejtën e realizimit të projekteve me rëndësi kombëtare, mund të jenë specializuar në fushën e ndërtimeve publike por mund të mos jenë të specializuar për të kryer veprimtari minerare. Në kushte të tilla këto subjekte nënkontraktajnë shoqëri të tjera për të kryer këtë veprimtari. Për këtë arsye është menduar që në ligjin minerar të parashikohet që Leja e shfrytëzimit të karrierave për qëllime publike vendore ose kombëtare t'i jepet edhe subjekteve pjesmarrëse në realizimin e projektit.

Pamundësia e zgjatjes së lejes minerare në rastet kur vazhdimi i shfrytëzimit bie ndesh me projekte të tjera që kanë interes publik.

Në ligjin minerar është parashikuar e drejta e zgjatjes së lejes minerare të shfrytëzimit në rastet kur zotëruesi i saj i ka plotësuar detyrimet financiare, ka kryer investimet e parashikuara në programin e punës, në përputhje me lejen e dhënë, dhe paraqet një program pune shtesë, bindës për ministrin. Duke qënë se lejet minerare kanë afat 25 vjeçar, gjatë kësaj periudhe nga institucione përkatëse mund të planifikojnë të zhvillojnë projekte që kanë interes publik. Për këtë arsye në projektligj përveç kushteve të tjera për zgjatjen e lejes minerare, u parashikua se zgjatja e afatit miratohet kur vazhdimi i shfrytëzimit nuk bie ndesh projekte të tjera që kanë interes publik.

E drejta e pezullimit të përkohshëm të lejes së shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve ndërtimore

Ligji aktual minerar i jep të drejtën subjekteve që zotërojnë Leje shfrytëzimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, të pezullojnë përkohësisht veprimtarinë e shfrytëzimit në zonën e lejuar. Kjo e drejtë nuk është e parashikuar subjekteve që zotërojnë Leje shfrytëzimi me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve ndërtimore. Tregu i materialeve ndërtimore ka pasur herë pas here luhatje, zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve ndërtimore kanë qënë të detyruar të vazhdojnë prodhimin dhe të krijojnë një stok material duke qënë se ligji minerar nuk kishte të parashikuar të drejtën e pezullimit të përkohshëm të veprimtarisë për këtë grup. Sa më sipër, në projekt ligj u parashikua e drejta e pezullimit të përkohshëm të veprimtarisë së shfrytëzimit në zonën e lejuar, si dhe kushtet kur i miratohet pezullimi subjektit minerar.

Zgjatja e afatit të lejeve të dhëna sipas ligjit nr. 7796, datë 17.2.1994

Në nenin 23 është parashikuar ndryshim i pikës 2, të nenit 57. Me këtë ndryshim, për të drejtat minerare të fituara në bazë të ligjit nr. 7796, datë 17.2.1994 "Ligji minerar i Shqipërisë", zotëruesit të lejes së shfrytëzimit të grupit të mineraleve metalore i jepet e drejta e shtyrjes së afatit të vlefshmërisë dy herë. Shtesa e parë me të drejtë shtyrje 10 vjet dhe shtesa e dytë me të drejtë shtyrje 5 vjet, me kusht që kjo shtyrje të kërkohet çdo herë të paktën 365 ditë kalendarike para përfundimit të afatit të vlefshmërisë, ndërsa zotëruesi i lejes së shfrytëzimit të grupit të mineraleve ndërtimore ka të drejtën e shtyrjes së afatit të vlefshmërisë tre herë. Shtesa e parë me të drejtë shtyrje 10 vjet, shtesa e dytë me të drejtë shtyrje 10 vjet dhe shtesa e tretë me të drejtë shtyrje 5 vjet, me kusht që kjo shtyrje të kërkohet çdo herë të paktën 180 ditë kalendarike para përfundimit të afatit të vlefshmërisë.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat e synuara të propozimit janë si më poshtë:

- Të përmirësohet klima e biznesit nëpërmjet lehtësimit të procedurave ligjore, lejimit të mundësisë së transferimit të lejeve të dhëna me procedurë konkurruese.
- Të rritet mundësia e investimeve më të shpejta në kohë për veprimtarinë e kërkim zbulimit nëpërmjet uljes së vlerës së garancisë nga 100% në 10%.
- Të lejohet vazhdimi i investimeve në veprimtarinë e kërkim zbulimit për materialet ndërtimore nëpërmjet dhënies së të drejtës së shtyrjes së afatit të lejes për një vit.
- Të mbështeten projektet kombëtare nëpërmjet dhënies së Lejes së shfrytëzimit të karrierave për qëllime publike vendore ose kombëtare subjekteve pjesmarrëse në realizimin e projektit, si duke mos lejuar zgjatjen e lejes minerare në rastet kur vazhdimi i shfrytëzimit bie ndesh me projekte të tjera që kanë interes publik.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e objektivave të politikës së propozuar, janë shqyrtuar tre opsione:

“**Opsioni 0**” – Ruajtja e “status quo-së”, ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010, “ Per sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

“**Opsioni 1**” –Miratimi i një ligji të ri.

“**Opsioni 2**” – Ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuara dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuara mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet e opsionit të preferuar janë si vijon:

- **Ndikimi ekonomik** sasior– Ndryshimet e propozuara me anë të këtij projektligji kanë ndikim në:
- Rritjen e mundësisë së investimeve më të shpejta në kohë për veprimtarinë e kërkim zbulimit nëpërmjet uljes së vlerës së garancisë nga 100% në 10%.
- Rritjen e investimeve në veprimtarinë e kërkim zbulimit për materialet ndërtimore nëpërmjet dhënies së të drejtës së shtyrjes së afatit të lejes për një vit. Për sipërfaqen e mbajtur për vitin e dytë subjekti do të paguaj 150 000 lekë/km², duke i dhënë kështu mundësinë subjekteve të përfundojnë punimet e kërkim zbulimit për pjesën e mbetur.

Ndikimi cilësor – Ndryshimet në projektligjin e propozuar do të ndikojnë në:

- Përmirësimin e klimës së biznesit nëpërmjet lehtësimit të procedurave ligjore, lejimit të mundësisë së transferimit të lejeve të dhëna me procedurë konkurruese.
- Rritjen e investimeve në veprimtarinë e kërkim zbulimit për materialet ndërtimore nëpërmjet dhënies së të drejtës së shtyrjes së afatit të lejes për një vit.
- Mbështetjen e projekteve kombëtare nëpërmjet dhënies së Lejes së shfrytëzimit të karrierave për qëllime publike vendore ose kombëtare subjekteve pjesmarrëse në realizimin e projektit, si duke mos lejuar zgjatjen e lejes minerare në rastet kur vazhdimi i shfrytëzimit bie ndesh me projekte të tjera që kanë interes publik.
- **Ndikim mjedisor** . Nuk ka ndikim mjedisor.
- **Ndikim social**. Nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë social.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuara monetare.

Opsioni 2. Ndryshimin e ligjit ekzistues nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është opsioni i preferuar.

Ky opsion lehtëson procedurat ligjore për biznesin nëpërmjet lejimit të mundësisë së transferimit të lejeve të dhëna me procedurë konkurruese, rritjes së mundësisë së investimeve më të shpejta në kohë për veprimtarinë e kërkim zbulimit nëpërmjet uljes së vlerës së garancisë nga 100% në 10%, vazhdimi të investimeve në veprimtarinë e kërkim zbulimit për materialet ndërtimore nëpërmjet dhënies së të drejtës së shtyrjes së afatit të lejes për një vit.

Gjithashtu ndryshimi i ligjit mbështet projektet kombëtare nëpërmjet dhënies së Lejes së shfrytëzimit të karrierave për qëllime publike vendore ose kombëtare subjekteve pjesmarrëse në realizimin e projektit, si duke mos lejuar zgjatjen e lejes minerare në rastet kur vazhdimi i shfrytëzimit bie ndesh me projekte të tjera që kanë interes publik.

Ndryshimet e propozuara me anë të këtij projektligji nuk kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në vlerë monetare, por ndikojnë në rritjen e mundësisë së investimeve më të shpejta në kohë në veprimtarinë minerare.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsytet pse?)

Në datë 19.02.2020 në ambjentet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë u zhvillua një takim me përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Platforma e Bashkëqeverisjes, përfaqësues të subjekteve minerare dhe me Presidentin e Shoqatës së Minierave z. Adhurim Çausi për të diskutuar rreth ndryshimeve në Ligjin Nr. 10304, datë 15.07.2010.

Të ftuar për të qenë të hapur në diskutim përfaqësuesit e subjekteve minerare folën rreth problematikave që has biznesi duke propozuar disa ndryshime si më poshtë:

- U propozua që në nenin 17/1, të parashikohet mundësia e paisjes me leje minerare të subjekteve pjesmarrëse në realizimin e projekteve për qëllime publike vendore ose kombëtare

Ky propozim u pranua pasi në ligjin minerar është parashikuar mundësia e paisjes me leje shfrytëzimi të karrierave për subjektet të cilat kanë fituar të drejtën e realizimit të projekteve me rëndësi kombëtare apo lokale. Momentalisht kjo e drejtë i jepet vetëm subjektit të krijuar nga njësisia përkatëse e qeverisjes vendore ose subjektit, i cili ka fituar të drejtën e realizimit të projektit me rëndësi kombëtare.

Subjektet të cilat fitojnë të drejtën e realizimit të projekteve me rëndësi kombëtare, mund të jenë specializuar në fushën e ndërtimeve publike por mund të mos jenë të specializuar për të kryer veprimtari minerare. Në kushte të tilla këto subjekte nënkontratojnë shoqëri të tjera për të kryer këtë veprimtari. Për këtë arsye ky propozim u pranua dhe në draft ligj u parashikua që Leja e shfrytëzimit të karrierave për qëllime publike vendore ose kombëtare t'i jepet edhe subjekteve pjesmarrëse në realizimin e projektit.

- U propozuan që faturimi i rentës minerare të bëhet sipas mineralit të thatë, sepse lagështia e mineralit e përlogaritur sjell dëm monetar për shoqërinë. Renta minerare llogaritet në përqindje të vlerës së siguruar nga shitja e mineralit të papërpunuar, të prodhuar nga zona e lejuar minerare, dhe derdhet në Buxhetin e Shtetit dhe në buxhetin e njësisive të qeverisjes.

Ky propozim u pranua duke ndryshuar në pikën 23, ku përcaktohet përkufizimi i "Rentës

minerare", pas fjalës "mineralit" shtohen fjalët "të thatë".

- U propozua që subjektet, të cilat kanë në zotërim më shumë se 1 leje në të njëjtin vend dhe jo me shumë distancë midis tyre, propozuan bashkimin e lejeve të tyre në një të vetme.

Ky propozim nuk u pranua pasi çdo Leje minerare ka afate dhe detyrime të ndryshme.

- U propozua që të ulet vlera monetare e gjobave kundrejt subjekteve në lidhje me informacionet 3 mujore të punës. Si dhe u diskutua mbi kthimin e këtyre informacioneve nga 3 mujore në 6 mujore.

U pranua vetëm ndryshimi i afatit të informacioneve nga 3 në 6 muaj.

- U propozua shtyrja e afateve për të gjitha llojet e lejeve edhe 10 vite të tjera më shumë seç është përcaktuar në ligj.

Ky propozim u pranua pjesërisht duke ndryshuar vetëm afatin e shtyrjes për lejet e dhëna sipas ligjit nr. 7796, datë 17.2.1994 "Ligji mineralar i Shqipërisë" dhe duke i dhënë kështu edhe lejeve të vjetra një afat vlefshmërie në total të njëjtë me ato leje të dhëna sipas ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin mineralar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe strukturat përgjegjëse të saj do të monitorojnë zbatimin e procedurave të parashikuara në ligjin e ri.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Ligji Nr. 10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin mineralar në Republikën e Shqipërisë" përcakton rregullat për zhvillimin e veprimtarive minerare e postminerare në Republikën e Shqipërisë dhe ka për qëllim nxitjen e veprimtarisë minerare në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet sigurimit të transparencës dhe të konkurrencës së lirë në zhvillimin e kësaj veprimtarie, rritjen maksimale të përfitimit publik nga veprimtaria minerare dhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik nga rreziku mineralar dhe ai i mbetjeve të industrisë minerare.

Ligji nr. 10 304, datë 15.7.2010 është ndryshuar me ligjin nr. 9/2013 "Për një ndryshim në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin mineralar në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 134/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, "Për sektorin mineralar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" dhe ligjin nr. 68/2019 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, "Për sektorin mineralar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Menaxhimi i veprimtarisë minerare në zbatim të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pas një periudhe rreth 6 (gjashtë) vjeçare, ka nxjerrë në pah nevojën e ndryshimeve ligjore me qëllim përmirësimin e mëtejshme të procedurave ligjore dhe lehtësimin e biznesit që ushtron veprimtari minerare.

Amendimet legjislative, të përfshira në draftin e projektligjit përfshijnë një sërë shtesash, përmirësimesh dhe riformulimesh, të cilat synojnë azhormimin e tij me zhvillimet e reja në fushën e veprimtarisë minerare.

Grupet e prekura nga ky propozim janë subjektet juridike që kryejnë veprimtari në fushën minerare.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendësi punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Ndërhyrja në këtë ligj është e nevojshme për të krijuar një klimë të favorshme për shoqëritë që ushtrojnë veprimtari minerare si dhe për të nxitur investimet e reja në sektorin minerar.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrje qeveria shpreson të rris mundësinë e investimeve më të shpejta në kohë për veprimtarinë e kërkim zbulimit nëpërmjet uljes së vlerës së garancisë nga 100% në 10%, të rris mundësinë e investimeve të reja në veprimtarinë e kërkim zbulimit për materialet ndërtimore nëpërmjet dhënies së të drejtës së shtyrjes së afatit të lejes për një vit, të përmirësoj klimën e biznesit nëpërmjet lehtësimit të procedurave ligjore, lejimit të mundësisë së transferimit të lejeve të dhëna me procedurë konkurruese, të mbështes shoqëritë të cilat realizojnë projekte kombëtare.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat kryesore të këtij propozimi janë:

- Të përmirësohet klima e biznesit nëpërmjet lehtësimit të procedurave ligjore, lejimit të mundësisë së transferimit të lejeve të dhëna me procedurë konkurruese.
- Të rritet mundësia e investimeve më të shpejta në kohë për veprimtarinë e kërkim zbulimit nëpërmjet uljes së vlerës së garancisë nga 100% në 10%.
- Të lejohet vazhdimi i investimeve në veprimtarinë e kërkim zbulimit për materialet ndërtimore nëpërmjet dhënies së të drejtës së shtyrjes së afatit të lejes për një vit.
- Të mbështeten projektet kombëtare nëpërmjet dhënies së Lejes së shfrytëzimit të karrierave për qëllime publike vendore ose kombëtare subjekteve pjesmarrëse në realizimin e projektit, si duke mos lejuar zgjatjen e lejes minerare në rastet kur vazhdimi i shfrytëzimit bie ndesh me projekte të tjera që kanë interes publik.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Janë identifikuar tre opsione të mundshme, si vijon:

Opsioni 0 status quo - Ky opsion nuk nxit investimet në veprimtarinë minerare si dhe nuk lejon mundësinë për të përmirësuar kuadrin ligjor me qëllim lehtësimin e biznesit që ushtron veprimtari minerare.

“**Opsioni 1**” – Miratimi i një ligji të ri. Nuk është konsideruar ndryshimi në tërësi i ligjit duke qenë se të gjitha parashikimet e tij do të mbeten në fuqi dhe shtesat dhe ndryshimet që do të miratohen janë në një masë të vogël. Si e tillë, nuk vlerësohet i nevojshëm propozimi i një ligji të ri.

“**Opsioni 2**” – Ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ky opsion që propozohet nxit investimet në veprimtarinë minerare si dhe lejon mundësinë për të përmirësuar kuadrin ligjor me qëllim lehtësimin e biznesit që ushtron veprimtari minerare.

Përzgjedhja e opsioneve është mbështetur në vlerësimin e ndikimit cilësor, pas analizës së të cilit rezultoi se në opsionin e dytë konstatohet një ndikim pozitiv duke qenë se redukton barrierat dhe lehtëson klimën e biznesit.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasimore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Opsioni i zgjedhur në varësi të ndikimit prek grupet

- **Ndikim të drejtpërdrejtë.**

-Subjektet Juridike që kryejnë veprimtari në fushën minerare si dhe te subjektet të cilat kanë fituar të drejtën e realizimit të projekteve kombëtare.

Ndryshimi i propozuar me anë të këtij projektligji nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në vlerë monetare, për këtë arsye nuk vlerësohen kostot dhe përfitimet që mund të sillte ky ndryshim dhe për rrjedhojë dhe risqet dhe kufizimet.

Opsionet e vlerësuara nga grupi teknik i punës u kryen duke analizuar numrin e dispozitave dhe neneve që ndryshohen dhe shtohen për të arritur qëllimet/objektivat e këtij projekt akti. Krahasimi është bërë duke u nisur nga numri total i neneve të projektligjit ekzistues dhe nenet që ndryshohen dhe shtohen.

Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është relativisht i ri, i përafëruar plotësisht me: 32006L0021, Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 2006/21/KE, datë 15 mars 2006 "Për menaxhimin e mbetjeve nga industritë nxjerrëse". Miratimi i një ligji të ri, përveçse do të ishte me kosto të larta dhe do të kërkonte një kohë do të konsiderueshme për t'u përgatitur, ajo çfarë është me e rëndësishme do të prekte çështje sensitive në sektorin minerar. Në përfundim u arrit në konkluzionin që paraqitja e projekt aktit të jetë në formën e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është opsioni më i përshtatshëm.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni i përzgjedhur është opsioni nr 2, për për arsye si më poshtë vijon:
Propozimi për ndryshimin e ligjit ekzistues nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nxit investimet në veprimtarinë minerare si dhe lejon mundësinë për të përmirësuar kuadrin ligjor me qëllim lehtësimin e biznesit që ushtron veprimtari minerare.

Lehtësimi i mëtejshëm i procedurave që lidhen ngushtësisht me biznesin, nëpërmjet ndryshimeve ligjore që nxisin investimet në veprimtarinë minerare, mund të arrihet vetëm me anë të disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin ekzistues nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Për zbatimin e opsionit të përzgjedhur njësi përgjegjëse do të jetë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe strukturat përgjegjëse të saj.

Për zbatimin e këtij opsioni nuk parashikohen pengesa duke qënë se pas ndryshimit të propozuar e vetme njësi përgjegjëse zbatimit e ndryshimeve ligjore është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me strukturat përgjegjëse të saj.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në kuadër të zbatimit të objektivit të politikës do të ndërmarr masat e nevojshme:

- Ndryshimet në aktet nënligjore që preken nga ky projektligj.
- Informimin e grupeve të interesit të prekura nga këto ndryshime.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit.

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

-Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim monitorimin dhe zbatimin e opsionit të preferuar, do të komunikojë me komunitetin e biznesit dhe do të mbledhë prej tyre mendime, nëse ka

pasur përmirësime në procedurat e të bërit biznes, në zbatim të ndryshimeve që burojnë nga opsioni i përgjedhur.

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për minierat, do të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 22 dhe nenit 23, të projektligjit.

- Treguesit matës për arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre do të jenë:
 - a) vlera e investimit në objektet e veprimtarisë minerare.
 - b) koha e kryerjes së investimeve.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

(Nuk ka impakt buxhetor)

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			

Opsioni 2			
-----------	--	--	--